



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

KF.nr.7/2022

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi në kontestin tregtar administrativ të paditësit “M...” ShPK me seli në Shtime, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shemsi Imeri, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlerë kontesti e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik, të mbajtur në prani të pronarit të biznesit M.R dhe përfaqësuesit të paditësit Sh.I, si dhe në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të të paditurit, me datë 19.09.2022 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET Pjesërisht kërkesëpadia e paditësit “M...” ShPK me seli në Shtime, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sh.I dhe atë vetëm sa i përket kontestit të deklarimit të stoqeve për vitin 2014.
- II. ANULOHET Pjesërisht vendimi nr. ... i datës 06.09.2019, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë vetëm sa i përket vlerësimit të stoqeve për vitin 2014, dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE, tek e paditura lidhur me këtë pjesë.
- III. REFUZHET kërkesëpadia e paditësit “M...” ShPK me seli në Shtime, lidhur me kontestin e deponimeve bankare, huazimin e mjeteve dhe shpenzimet e derivateve të naftës, për periudhën kontestuese 2013 deri 2015, si e pabazuar
- IV. Mbetet në fuqi vendimi nr.311/2019 i datës 06.09.2019 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, në pjesët referuar deponimeve bankare, huazimit të mjeteve dhe shpenzimet e derivateve të naftës, për periudhën kontestuese 2013 deri 2015.
- V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 09.10.2019, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurit Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë, ndaj vendimit nr. 311/2019 të datës 06.09.2019, për shkak të: vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale dhe dëmtimit material të subjektit tatimor. Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi – pronari i paditësit deklaroi se kontrolli është hapur për periudhën tatimore 2013-2015 për Tatimin në të Ardhuara të Korporatave, dhe periudha 03.2013 deri 12.2015 për TVSH. Pretendimet e padisë janë të përfshira në padi dhe janë katër pika kontestuese. E para dhe shumë e rëndësishme ka të bëjë me ndryshimin e vlerës së Stokut për vitin 2014 dhe 2015, ku inspektori ka ndryshuar një vlerë nga 246,752.20 € në 180,507.19 €. Përvojën time mbas 30 vjeçare nuk na ka ndodhur asnjëherë që të ndryshoj Stoku për vitet e kontrollës, përveç Stokun momental që e kanë has inspektorët në momentin e hapjes së kontrollës, duke verifikuar Stokun, e kjo i bie që me 19.04.2019 ka mundur inspektori të ndryshojë Stokun momental me atë që ne e prezantojmë me libra, kurse Stoqet e viteve paraprake duhet të mbesin ashtu siç janë paraqitur në pasqyrë. Tutje, e njoftoj gjykatën se ATK në muajin 10.2014 ka pasur një vizitë të verifikimit të pjesshme të Stoqueve, dhe ne për atë mungesë e kemi përfshirë në pasqyrat financiare të vitit 2014, që i bie se kemi prezantuar Stoqet gjatë kontrollës ashtu siç kanë qenë në pasqyrat e vitit 2014 dhe 2015, dhe nuk e dimë se si inspektori ka ardhur deri tek ndryshimet duke iu referuar vizitës së Muajit 10.2014, ngase e ritheksoj se kjo vizitë i referohet vetëm kontrollës së pjesshme të Stokut. E dyta është deponimet bankare, përshkimi i bankave komerciale futë mjaftë huti gjatë kontrollave të ATK-së, sepse të gjitha paret e gatshme të dorëzuara në bankë, banka i përshkruan si deponime. Ndërsa nga deponimet nga shitja dhe deponimi nga tregu ditor mund të merren si e hyrë e biznesit, kurse të hyrat tjera që janë marrë si qarkullim shtesë munden me qenë si të hyra nga huazimet dhe deponimet vetanake të pronarit të biznesit. Pika e tretë i referohet mospranimit të shpenzimeve të derivateve nga firma “A...” me seli në Shtime, në vlerën 10,475.00 €, sepse këto janë marrë për nevoja të firmës, dhe fatura është e përmbyllur nëpërmjet bankës TEB me datën 12.01.2016, kur nuk ka qenë e hapur edhe kontrolli, e këto derivate janë shpenzuar për nevoja të biznesit. Dhe e fundit ka të bëjë me huazimin pa interes me mundësi kthimi në kohë të pacaktuar vlera 50,000.00 €, nga A.Sh, nga Shtimja, e ku ky huazim duhet të zbritet nga shuma e deponimeve me të cilat inspektori na ka ngarkuar prej 20.01.2013, bazuar në kontratën e lidhur. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 06.11.2020, ka kundërshtuar pretendimet e paditësit të parashtruara në padi si të pabazuara në ligj dhe fakte materiale. ATK-ja ka realizuar kontrollin bazuar në dokumentacionin e vet tatimpaguesit, aktivitete- vizita paraprake të realizuara nga ATK te tatimpaguesi dhe informatave nga palët e treta. Duke pas parasysh se paditësi nuk ka deklaruar qarkullim real, lidhur me periudhat e kontrollit, ATK-ja bazuar në nenin 14, 15 dhe 19 të Ligjit 03/L222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat ka realizuar kontroll mbi bazë e fakteve më të besueshme dhe mbi bazën e gjendjes faktike të konstatuar. Pretendimi i paditësit se ATK-ja pa të drejtë e ngarkon me qarkullim shtesë në TVSH dhe CD për vitet 2013 dhe 2017, aspak nuk qëndron, sepse kontrollat te tatimpaguesi është kryer duke u bazuar në të dhënat e tatimpaguesit, verifikimin e dokumentacionit, analizimin e llogarive bankare dhe i është kërkuar paditësit ditari i arkës për të arsyetuar deponimet bankare e për të cilin paditësi është i obliguar që të mbaj sipas ligjit 05/L-029 për Tatim në të Ardhura të Korporatave. Kontrollat duke analizuar dosjet e tatimpaguesit vërteton se stoqet me kontroll janë marr duke u bazuar në verifikimin e librave dhe regjistrimeve të stoqeve, për vitin 2013 kontrollat konstaton se në bazë të të hyrave nga deponimet përmes llogarive bankare, tejkalojnë qarkullimin sipas deklarimeve të tatimpaguesit, ndërsa në vitin 2014 pas ekzaminimit të dokumenteve që i ka disponuar kontrollat, ka ardhur në përfundim se vlera e stoqeve sipas fletëregjistrimit të tatimpaguesit është 180,507.17€, ndërsa pas rregullimit të stoqeve në fund të vitit 2014 pasqyra vjetore paraqitet më e madhe kostoja se të hyrat e deklaruara nga tatimpaguesi. Kontrollat koston e mallrave të shitura e ka dhënë marzhën mesatare nga viti paraprak të deklaruar nga vet tatimpaguesi prej 26.61% në deklaratën vjetore CD/2013, gjatë kontrollit është konstatuar se të hyrat nga deponimet përmes llogarisë bankare tejkalojnë qarkullimin sipas deklarimeve të tatimpaguesit, ndërsa nuk e tejkalojnë qarkullimin pas vendosjes së marzhës nga ana e kontrollit. Gjatë vitit 2015 tatimpaguesi në pasqyrën e të ardhurave ka paraqitur KMS-në më të madhe se të hyrat për arsye të bartjes së stokut gabim nga periudha 31.12.2014, sepse gjatë verifikimit të dosjes dhe regjistrimeve të mallit të bërë nga tatimpaguesi me datë 31.12.2014, stoku me këtë datë ka qenë 180,507.19€, e jo siç ka paraqitur tatimpaguesi në pasqyrën e të ardhurave në fund të vitit 2014 në vlerën prej 246,752.20€ e cila vlerë është bartur në vitin 2015, ku në pasqyrën e të ardhurave 2015 KMSH-ja është paraqitur më e madhe se të hyrat. Për këtë arsye edhe deklarata vjetore CD/2015 e deklaruar nga tatimpaguesi është paraqitur me humbje në vlerë prej 50,625.04€. kontesti i llogarive bankare tek vlerësimi i deponimeve, kontrollat është bazuar në nenin 30 paragrafi 3.2 i Udhëzimit administrativ nr.15/2010 për zbatimin e ligjit 03/L-222, ku në përshkrimin e

bankës deponim bankar inspektori e ka përllogaritur si e hyrë e tatimpaguesit ku ka zbritur qarkullimin e deklaruar dhe diferencën e ka kalkuluar si qarkullim shtesë, ndërsa nga divizioni i ankesave nuk është marr për bazë kontrata e huas për faktin se të përshkrimi i bankës huazim kontrolli nuk e ka kalkuluar si qarkullim shtesë. Po ashtu, kontesti i tatimpaguesit me faturat e derivateve të naftës, ATK-ja gjatë procedurës së kontrollës, tatimpaguesit i ka kërkuar edhe listat e mjeteve themelore dhe arsyetimin e shpenzimeve për të cilat nuk i ka sjellë dhe argumentuar, prandaj me kontroll është konstatuar se kjo blerje me sasi të madhe nuk është shfrytëzuar për nevoja biznesore dhe këtë blerje kontrolli e ka cilësuar me çmim të kostos. Nisur nga faktet e prezantuar më lartë ATK-ja i propozon gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe vërtetohet si i bazuar vendimi i DA NR. ... I DATËS 06.09.2019. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura ndonëse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe e ka pranuar ftesën për këtë seancë me datën 05.09.2022, e njëjta nuk ka prezantuar, por me parashtrësën e datës 12.09.2022, e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë, duke kërkuar nga gjykata që të veprojë në pajtim me nenin 38 par.5 të LKA-së, andaj edhe gjykata ka proceduar tutje në mungesë të saj.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës 19.09.2022 ka administruar provat dhe atë: Vendimi 311/19 i datës 06.09.2019, Fatura nr. ..., Kopja e Llogarisë Bankare e Muajit 01.2016, Urdhrat për Shfrytëzimin e Automobilit të udhëtarëve për punë zyrtare e datës 24.03.201 dhe 08.04.2015, Raporti i Kontrollit nr. ..., Rivlerësimet për TVSH-në për periudhat tatimore 11.2008 dhe 12.2008, Përgjigja në Draft Raport e datës 02.06.2019, Kontrata e Huazimit e datës 20.01.2013, Përgjigja në Padi e datës 06.11.2020, Ankesa e ushtruar në ATK e datës 11.07.2019, Raporti i Kontrollit nr. ..., Qarkullimi për Llogari Bankare NLB Banka për periudhën 01.01.2013 deri 31.12.2015, Monitorimi i llogarisë në TEB për periudhën 21.10.2014 deri 01.09.2015, Llogarisë Bankare në Raiffeisen Bankë për periudhën 01.01.2013 deri 31.12.2015, Tabela Deponimet NLB Bankë për vitin 2014, Regjistrimi i datës 31.12.2014 i subjektit-këtu paditësit në Shtime dhe Regjistrimi i datës 31.12.2014 i subjektit-këtu paditësit në Depon në Prishtinë, Libri i Shitjes për vitin 2013, 2014, 2015, Libri i Blerjes për vitin 2013, 2014, Tabela Gjendja e Përgjithshme e Deklarimeve dhe Transaksioneve të Tjera e datës së printimit 11.04.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese fakti se paditësi ka pranuar raportin e kontrollit nr. ... të datës 03.06.2019, nga e paditura, me ç' rast nga gjetjet e të njëjtit është konstatuar qarkullim dhe tatim shtesë si dhe janë aplikuar ndryshime në : TVSH-ë për periudhën 03/2013 deri 12/2015 dhe CD për periudhën 2013 deri 2015. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë departamentit të ankesave në ATK-ë, e për të cilën ankesë, ATK-ja me datë 06.09.2019, ka sjell vendimin nr. 311/2019, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, e ndaj të cilit paditësi me padinë e datës 06.10.2019, ka iniciuar këtë konflikt administrativ.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata me përjashtim të çështjes kontestuese të ndryshimit të vlerës së stokeve për vitin 2014, ka pranuar pjesërisht si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Gjykata konstaton se vlera e stokeve të deklaruara nga paditësi në fund të vitit 2014 ka qenë 246,752.20€, ndërsa e paditura ka ndryshuar këtë vlerë duke i mbështetur në disa regjistrime të stokeve që janë bërë me datë 28.10.2014 dhe ka konstatuar se vlera reale e stokeve pas disa rregullimeve është 180,507.19€. një konstatim i tillë për gjykatën është i pabazuar, sepse nuk mund të konstatohet gjendja reale e stokeve në muajin 10.2014, pasi që stoqet regjistrohen dhe deklarohen në fund të vitit. Për më tepër e paditura nuk

mund ta konstatoj gjendjen reale të stoqeve për një periudhë të kaluar, kur e njëjta verifikohet dhe deklarohet në momentin e numërimit të tyre.

Sa i përket pretendimit të paditësi se e paditura të gjitha deponimet në llogarinë bankare i ka trajtuar si të hyra të biznesit, gjykata konstaton se një pretendim i tillë është i pabazuar sepse nga verifikimi i gjendjeve të llogarive bankare, si të hyra nga ana e kontrollit janë trajtuar pazari ditor dhe deponimet ne para të gatshme për të cilat nuk ka pas përshkrim shtesë se nga ka rrjedh kjo para, ndërsa deponimet të cilat në përshkrim kanë pasur “huazim”, nuk janë trajtuar si të hyra të biznesit. Rrjedhimisht nuk qëndron edhe pretendimi i paditësit se e paditura nuk e ka marr për bazë kontratën e huas të lidhur në mes të paditësit si huamarrës dhe huadhënësit A.Sh në vlerë prej 50,000.00€, për arsye se siç u cek edhe më lart, të gjitha të hyrat në llogari të cilat kanë pas përshkrimin “huazim” nuk janë marr nga kontrolla si të hyra të biznesit.

Nuk qëndron as pretendimi tjetër i paditësit i cili ka të bëjë me mospranimin e derivateve të naftës në vlerë prej 10,475.00€, për arsye se edhe pse paditësi ka paraqitur faturën dhe transaksionin bankar në emër të faturës, i njëjti nuk ka arritur të argumentoj se këto shpenzime janë bërë për qëllime biznese. Paditësi në këtë rast është dashur të deklaroj librin e shpenzimeve të derivateve dhe mjetet themelore nga të cilat janë shpenzuar këto derivate.

Rrjedhimisht, gjykata konkludon se paditësi në këtë kontest tregtar administrativ vetëm pjesërisht ka arritur që t’i vërtetoj faktet që e mbështesin kërkesën e tij dhe atë për çështjen e vlerës së stoqeve për vitin 2014, prandaj gjykata vendosi që në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi të aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe të anuloj pjesërisht vendimin me nr.311/2019 të datës 06.09.2019 të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendose tek e paditura lidhur me këtë pjesë, ndërsa për çështjen e të deponimeve bankare, huazimit në vlerë prej 50,000.00€ dhe shpenzimet e derivateve të naftës, gjykata e refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenin 43 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.7/22 datë 19.09.2022

Bashkëpunëtori Profesional

Visar GASHI

---

Gj y q t a r i,

Fisnik NULI

---

#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.